**LIGJ**
**Nr. 66/2022**

# PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SIGURISË DHE LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT

Në mbështetje të neneve 78, 83, 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.9.2022.
**Shpallur me dekretin nr. 13854, datë 27.9.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

## MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SIGURISË DHE LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Brendshme, dhe qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe, e përfaqësuar nga Ministria e Brendshme, dhe (në vijim referuar kolektivisht si "Palët" dhe individualisht si "Pala"),

*me dëshirën* për të zhvilluar lidhjet e miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe duke kontribuar në rritjen e bashkëpunimit të tyre në fushën e ruajtjes së sigurisë dhe luftës kundër krimit;

*me qëllim* zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre në fushën e luftës së krimit në të gjitha format e tij dhe mbrojtjen e ligjit dhe rendit publik;

*të vetëdijshëm ndaj* kërcënimit serioz që paraqet terrorizmi, krimi i organizuar dhe format e tjera të krimeve që kërcënojnë sigurinë e të dyja vendeve;

*duke respektuar* parimet e sovranitetit dhe barazisë së shteteve dhe mosndërhyrjen në punët e brendshme, si dhe parimet e tjera të njohura në instrumentet e tjera ndërkombëtare të detyrueshme për secilën palë,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1
**Objekti i bashkëpunimit**

Palët do të bashkëpunojnë në bazë të kësaj Marrëveshjeje për të rritur bashkëpunimin dypalësh ndërmjet tyre, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, përvojave dhe trajnimeve, në të gjitha fushat e sigurisë dhe policisë brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe detyrimet e tyre ndërkombëtare.

Neni 2
**Fushat e bashkëpunimit**

Palët do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informacionit, me synimin për të parandaluar, zbuluar dhe luftuar veprat penale dhe fenomenet kriminale të mëposhtme:

1. Veprat terroriste, veprimtaritë e grupeve terroriste, drejtuesit e këtyre grupeve, pjesëtarët dhe vendet e përqendrimit dhe trajnimit të tyre;
2. Veprat penale të financimit të terrorizmit nën çdo kategori dhe mbështetjen e tij ose përdorimin e dyshuar në mbështetje dhe financim të terrorizmit, duke përfshirë parandalimin e pagesës së shpërblimeve për grupet terroriste;
3. Krimet e rënda kundër personit dhe pronës;
4. Veprat penale që përfshijnë korrupsionin;
5. Krimet e organizuara transnacionale;
6. Prodhimi dhe trafikimi i paligjshëm i armëve, municioneve, eksplozivëve dhe substancave bërthamore dhe kimike, materialeve radioaktive dhe biologjike, si dhe teknologjisë që lidhet me to dhe armëve të shkatërrimit në masë, dhe armëve jokonvencionale;
7. Trafikimi i personave;
8. Prodhimi i paligjshëm, kontrabanda dhe trafikimi i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, duke përfshirë prekursorët, kimikatet dhe materialet e tjera të përdorura në prodhimin e tyre;
9. Veprat penale të pastrimit të parave;
10. Veprat penale ekonomike dhe financiare;
11. Veprat penale që lidhen me dhunën në familje dhe shfrytëzimin e fëmijëve, veçanërisht aktivitetet *online*;
12. Veprat penale të falsifikimit dhe promovimit të monedhës, falsifikimi i dokumenteve zyrtare, dokumenteve financiare ose obligacioneve, letrave me vlerë, kartave të krediti dhe mjeteve të financimit;
13. Vjedhja dhe kontrabanda e veprave kulturore, historike dhe letrare me vlera artistike;
14. Veprat penale që lidhen me pronësinë intelektuale;
15. Veprat penale që lidhen me vjedhjen e automjeteve, kontrabandën dhe trafikimin e paligjshëm të tyre;
16. Veprat penale që lidhen me transportin dhe komunikimin;
17. Veprat penale të lidhura me taksat;
18. Veprat penale të teknologjisë së informacionit;
19. Çdo krim tjetër i rënë dakord reciprokisht nga palët.

Neni 3
**Shkëmbimi i informacionit**

Palët do shkëmbejnë informacionin në fushën e sigurisë, në luftën kundër krimeve dhe fenomeneve specifike, në fushat e bashkëpunimit sipas nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe do t'i zbulojnë ato, veçanërisht në informacionin e mëposhtëm:

1. Krimet që planifikohen të kryhen ose ato që janë kryer brenda kufijve gjeografikë të të dyja palëve;
2. Personat, bandat dhe grupet terroriste të dyshuar për kryerjen e këtyre krimeve;

3. Njerëzit e arratisur;
4. Njerëz që raportohen të zhdukur;
5. Shkëmbimi i informacionit mbi transaksionet financiare që lidhen me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, ose financimin e organizatave të paligjshme dhe veprave penale të lidhura me to;
6. Shkëmbim informacioni dhe përvojash në fushën e luftës kundër veprave penale që lidhen me shfrytëzimin seksual të fëmijëve;
7. Përdorimi i shpërndarjes së kontrolluar për zbulimin e trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe substancave të përdorura në prodhimin e tyre dhe çdo substancë tjetër të ndaluar;
8. Çdo informacion tjetër përkatës i rënë dakord reciprokisht nga palët.

Neni 4
**Shkëmbimi i përvojave**

Palët shkëmbejnë përvoja, në lidhje me luftën kundër krimeve dhe fenomeneve specifike në fushat e bashkëpunimit, sipas kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht në fushat e mëposhtme:
1. Mënyra e re e veprimit e përdorur në kryerjen e krimeve dhe teknikat e reja në luftën ndaj krimeve;
2. Përdorimi i paligjshëm i drogave të dyshuara si mjete të përdorura në kontrabandimin e tyre, si dhe metodat e fshehjes dhe rrugët e kontrabandimit, llojet e reja të materialeve të përdorura në prodhim dhe teknikat moderne të përdorura në prodhimin, si dhe teknikat dhe pajisjet moderne që përdoren në zbulimin dhe ekzaminimin;
3. Përvoja praktike dhe shkencore në lidhje me fushat e bashkëpunimit;
4. Sistemet teknologjike dhe zgjidhjet e sigurisë që lidhen me fushat e bashkëpunimit;
5. Legjislacioni dhe tekstet ligjore përkatëse, si dhe kërkimet shkencore;
6. Praktikat më të mira në fushën e sigurisë dhe policisë;
7. Bashkëpunimi dhe koordinimi në aktivitete ndërkombëtare për tema të rëndësishme;
8. Çdo temë tjetër e rënë dakord reciprokisht nga palët.

Neni 5
**Trajnimi**

Palët do të punojnë në kurse dhe programe të përbashkëta trajnimi që do të kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të personelit të tyre në parandalimin dhe kontrollin e krimit dhe fenomeneve kriminale të përfshira në këtë marrëveshje, veçanërisht në temat e mëposhtme:
1. Zbulimi i metodave kriminale;
2. Përdorimi i teknologjive moderne për zbulimin dhe luftimin e krimeve;
3. Metodat moderne të hetimit;
4. Forcimi i aftësive të mbrojtjes civile, shuarjes së zjarrit dhe kërkim-shpëtimit;
5, Fushën e asgjësimit të eksplozivëve;
6. Menaxhimi i emergjencave, krizave dhe fatkeqësive, brenda juridiksionit të të dyja palëve;
7. Çdo temë tjetër e rënë dakord reciprokisht nga palët.

Neni 6
**Bashkëpunimi i ardhshëm**

Kjo Marrëveshje nuk i pengon palët të zhvillojnë forma të tjera të bashkëpunimit të përbashkët, duke marrë parasysh parashikimet e nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

**Kërkesa për bashkëpunim në fushën e shkëmbimit të informacionit**

1. Në varësi të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, bashkëpunimi do të bëhet me kërkesë nga secila palë.

2. Kërkesa zyrtare për bashkëpunim bëhet me shkrim, por në raste urgjente ajo mund të bëhet me çdo mjet komunikimi të sigurt, për të cilin do të bihet dakord reciprokisht me kusht që të konfirmohet me kërkesë zyrtare brenda 3 ditëve. Nëse lind ndonjë dyshim në lidhje me vërtetësinë ose përmbajtjen e kërkesës, mund të kërkohet konfirmim shtesë i saj.

3. Kërkesat zyrtare për bashkëpunim duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e autoritetit kërkues dhe emrin e të kërkuarit nëse dihet;

b) qëllimin dhe arsyet e kërkesës;

c) një përshkrim të bashkëpunimit të kërkuar;

d) çdo informacion shtesë që mund të ndihmojë siç duhet në ekzekutimin e kërkesës për bashkëpunim.

4. Kërkesat për bashkëpunim duhet të nënshkruhen nga autoriteti kompetent i palës kërkuese.

Neni 8

**Refuzimi i kërkesës**

1. Pala e kërkuar mund të refuzojë, plotësisht ose pjesërisht, për të ekzekutuar ndonjë kërkesë të bërë në përputhje me këtë marrëveshje, nëse ekzekutimi i një kërkese të tillë mund të cenoj sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose mund të jetë në kundërshtim me legjislacionin e saj ose detyrimet ndërkombëtare.

2. Kërkesa për bashkëpunim mund të refuzohet nëse veprimi, në lidhje me të cilin kërkesa u dërgua, nuk është i ndëshkueshëm sipas ligjit të shtetit të palës së kërkuar.

3. Pala e kërkuar do të njoftojë menjëherë palën kërkuese të arsyet e refuzimit.

Neni 9

**Ekzekutimi i kërkesës**

1. Pala e kërkuar do të ndjekë procedurat e nevojshme për të siguruar në mënyrë urgjente dhe të plotë ekzekutimin e kërkesës. Pala kërkuese do të informohet menjëherë për rrethanat që mund të pengojnë ose shkaktojnë ndonjë vonesë në ekzekutimin e kërkesës.

2. Pala e kërkuar mund të kërkojë informacion shtesë, i cili mund të konsiderohet i nevojshëm për të ekzekutuar kërkesën.

3. Pala e kërkuar, nëse ka ndonjë arsye, mund të shtyjë ekzekutimin e kërkesës ose përcaktimin e kushteve specifike për ekzekutimin e saj. Nëse pala kërkuese bie dakord për kushte të tilla, ajo do t'iu përmbahet atyre.

4. Pala e kërkuar, me kërkesë të palës kërkuese, do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e kërkesës, përmbajtjes, bashkëlidhjet e saj, si dhe atë në lidhje me bashkëpunimin e dhënë. Nëse nuk është e mundur të ekzekutohet kërkesa pa ruajtur konfidencialitetin, pala e kërkuar do të informojë palën kërkuese, e cila më pas do të vendosë nëse është e pranueshme për të ekzekutimi i kërkesës në kushte të tilla.

5. Pala e kërkuar do të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur palën kërkuese për rezultatin e ekzekutimit të kërkesës.

Neni 10

**Kërkesa për bashkëpunim në fushën e shkëmbimit të përvojave dhe trajnimeve**

Kërkesa për bashkëpunim në fushën e shkëmbimit të ekspertizës dhe trajnimit do të shkruhet nga autoritetet kompetente në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, me kusht që procedurat dhe kostot për zbatimin e kërkesës të jenë dakordësuar nga të dyja palët, ashtu si ato e gjykojnë të arsyeshme.

Neni 11
**Rregullat e përdorimit të informacionit dhe dokumenteve të marra**

1. Palët nuk do të lejojnë përdorimin ose lëshimin e ndonjë informacioni ose dokumenti të marrë sipas kësaj Marrëveshjeje, për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara në kërkesë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër.
2. Informacioni i marrë nga secila palë nuk do t'i zbulohet asnjë pale të tretë pa pëlqimin me shkrim të palës tjetër.

Neni 12
**Shpenzimet e ekzekutimit**

Pala e kërkuar do të mbulojë shpenzimet e zakonshme të ekzekutimit të kërkesës për bashkëpunim sipas kësaj marrëveshjeje. Megjithatë, nëse ekzekutimi i një kërkese të tillë kërkon shpenzime të një natyre të jashtëzakonshme, palët do të këshillohen për të vendosur termat dhe kushtet në të cilat bashkëpunimi i kërkuar mund të sigurohet.

Neni 13
**Gjuha**

Një kërkesë për bashkëpunim, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet në gjuhën shqipe ose në gjuhën arabe, të përkthyer në anglisht.

Neni 14
**Takimet dhe konsultimet**

Përfaqësuesit e palëve, kur është e nevojshme, do të mbajnë takime pune dhe konsultime për të diskutuar rezultatet e bashkëpunimit dhe masat për të përmirësuar efikasitetin e tij.

Neni 15
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Në rast të një mosmarrëveshjeje që lind ose lidhet me këtë Marrëveshje, ose në lidhje me interpretimin ose zbatimin e saj, palët do të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjen me pëlqim të ndërsjellë nëpërmjet negociatave dhe konsultimeve në mirëbesim ose bazuar në një marrëveshje të veçantë ndërmjet palëve.
2. Gjatë periudhës së mosmarrëveshjes, palët janë të detyruara të zbatojnë të gjitha detyrimet e tyre të përcaktuara në këtë marrëveshje.
3. Mosmarrëveshja që lind nga kjo Marrëveshje nuk do t'i nënshtrohet asnjë ligji ndërkombëtar ose kombëtar, as nuk do t'i nënshtrohet juridiksionit të një gjykate kombëtare, të huaj ose ndërkombëtare, ose ndonjë pale të tretë.

Neni 16

**Marrëdhënia me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare**

1. Kjo marrëveshje nuk do të cenoj bashkëpunimin juridik dhe gjyqësor ndërmjet palëve në ekstradim ose ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale, që janë objekt i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare.

2. Kjo marrëveshje nuk do të paragjykojë të drejtat ose detyrimet e Palëve që dalin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare për të cilat janë palë.

Neni 17

**Autoritetet kompetente për bashkëpunim**

1. Me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, bashkëpunimi do të bëhet përmes autoriteteve të mëposhtme:

a) Për Republikën e Shqipërisë:

- Ministria e Brendshme;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Drejtoria e Antiterrorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për rastet kundër terrorizmit që lidhen ndërmjet dy shteteve;

b) Për Emiratet e Bashkuara Arabe:

- Ministria e Brendshme;
- Administrata e Përgjithshme e Policisë Federale Kriminale; Departamenti i Sigurimit të Shtetit/në lidhje me krimet e sigurisë së shtetit, rastet e terrorizmit dhe krimet që lidhen me armët e shkatërrimit në masë dhe armët jokonvencionale;
- Shërbimi Informativ Kombëtar/në lidhje me krimet që lidhen me sigurinë e jashtme të shtetit, rastet e terrorizmit dhe organizatat e paligjshme.

2. Në rast të ndonjë ndryshimi në autoritetet e sipërpërmendura, palët do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën.

3. Palët, kur është e nevojshme, do të identifikojnë pikat e kontaktit direkt dhe kanalet e komunikimit.

Neni 18

**Hyrja në fuqi, ndryshimi dhe përfundimi**

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit dhe do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit ndërmjet dy palëve për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet - në çdo kohë - me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve dhe do t'i nënshtrohet të njëjtave procedura në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë kohore të pacaktuar dhe secila palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, me një njoftim me shkrim dërguar palës tjetër, gjashtë muaj përpara, përmes kanaleve diplomatike, pa paragjykuar zbatimin e kërkesave të paraqitura përpara atij njoftimi dhe mbetet subjekt i kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Dubai, më 28.3.2022, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën arabe, shqipe dhe angleze. Të gjitha tekstet janë autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim, teksti anglisht do të mbizotërojë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Z. Bledar Çuçi**
Ministër i Brendshëm

PËR QEVERINË E EMIRATEVE
TË BASHKUARA ARABE
**Gjen. Ltn. Saif Bin Zayed Al Nahyan**
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Brendshëm